

# SI TË VAKSINOHENI KUNDËR COVID-19 UDHËZIME PËR BANORËT MBI 75 VJEÇ



*Përditësuar më 12 shkurt 2021*

## SI TË REZERVONI NJË TAKIM:

**Individët e moshave 75 vjeç e lart përfitojnë për t'u vaksinuar kundër COVID-19 në Massachusetts.**

Takimet, edhe pse në numër mjaft të kufizuar, mund të planëzohen online, duke vizituar [www.mass.gov/COVIDVaccineMap](http://www.mass.gov/COVIDVaccineMap). Banorët futin kodin e tyre zip ose përzgjedhin një vendndodhje nga harta në uebsajt dhe pastaj ndjekin mesazhet e gatishmërisë për të planëzuar takimin online.

Individët e moshës 75 vjeç e lart, që **nuk janë në gjendje ta përdorin ose e kanë të vështirë aksesin në Internet** për të planëzuar një vizitë online, mund të përdorin **Linjën e Planëzimit të Vaksinës në Massachusetts**:

**Telefononi te 2-1-1 (877-211-6277)  
ndiqni mesazhet e gatishmërisë për ndihmë me rezervimin e një takimi**

### **Orët e Funksionimit:**

E hënë – E enjte

8:30 AM deri 8:00 PM

E premte – E diel

8:30 AM deri 5:00 PM

Linja e Planëzimit të Vaksinës në Massachusetts ofrohet në anglishte dhe spanjishte dhe do të ketë përkthyes në dispozicion për të ndihmuar banorët, në rreth 100 gjuhë të tjera. Personat e moshave 75 vjeç e lart do të mund të flasin me një përfaqësues në telefon, që do t'i ndihmojë për të rezervuar një takim, përmes sistemit online të shtetit. **Këta përfaqësues kanë akses te po ato takime që ofrohen në uebsajtin publik dhe nuk mund të ofrojnë akses në takime të tjera.** Nëse nuk ka orare takimesh në dispozicion, telefonuesve do t'u jepet opsioni që të shtohen në një listë telefonimi për sajte të vaksinimit masiv. Ashtu do të marrin një telefonatë, sapo të krijohet mundësia për një takim në një sajt vaksinimi masiv dhe lista do të përdoret për t'i vendosur thirrjet sipas radhës kur janë regjistruar.

Linja e Planëzimit të Vaksinës në Massachusetts aktualisht ofrohet **vetëm për persona të moshës 75 vjeç e lart që nuk mund ta përdorin Internetin ose e kanë të vështirë ta përdorin**, prandaj nuk janë në gjendje ta organizojnë një takim përmes platformave në linjë. Linja e Planëzimit të Vaksinës në Massachusetts ofron mbështetje vetëm për të fiksuar një takim dhe punonjësit nuk mund t'u përgjigjen pyetjeve të përgjithshme për COVID-19 ose të ofrojnë këshilla për kujdesin mjekësor individual.

*Përditësuar më 12 shkurt 2021*



Për shkak të kërkesave tejet të shumta për takime dhe furnizimit të kufizuar me vaksina, takimet rezervohen shumë shpejt. Takime të reja do të shtohen vazhdimisht në uebsajt dhe sajtet e vaksinimit masiv ofrojnë numrin maksimal të takimeve në dispozicion. Hë për hë, sajtet e vaksinimit masiv i publikojnë oraret e lira për takime çdo javë, ndërsa disa sajte më të vogla edhe më shpesh. Nëse nuk arrini të siguronit një takim, vazhdoni të kontrolloni sajtin.

**Takimet mund të rezervohen në lloje të ndryshme sajtesh (d.m.th., në sajte të vaksinimit masiv, farmaci, sajte lokale të vaksinimit), të cilat gjenden në disa komunitete anembanë shtetit.**

Për të rezervuar një takim:

1. Vizitoni [www.mass.gov/CovidVaccineMap](http://www.mass.gov/CovidVaccineMap) dhe futni kodin tuaj zip ose klikoni mbi hartë
2. Përzgjidhni një vend dhe planëzoni një takim online
3. Mbani me vete informacion të rëndësishëm për ju, të tillë si kartën e sigurimeve mjekësore
4. Plotësoni formularin e vetë-certifikimit, që duhet ta paraqitni gjatë vizitës

Informacioni për organizata të komuniteteve dhe persona të moshave 75 vjeç e më lart mund të gjendet në [mass.gov/covidvaccine75](http://mass.gov/covidvaccine75)

## HOLLËSI TË MËTEJSHME

Vaksinat për persona të moshave 75 vjeç e lart filluan në 1 shkurt dhe do të vazhdojnë të ofrohen gjatë dimrit dhe pastaj në pranverë dhe në verë.

**Mund t'ju duhet të prisni disa javë për një vizitë te një vend afër jush.** Dora-dorës që Massachusetts furnizohet me sasi të mëtejshme vaksinash, do ta keni më të lehtë për të lënë takime vaksinimi.

### TË DHËNA PËR TAKIMIN:

**Vaksinat ofrohen falas.** Kur ta keni caktuar vizitën, sajti i vaksinimit do t'ju japë hollësi specifike në lidhje me çfarë duhet të sillni me vete në takim. Sillni me vete në takim kartën e sigurimeve mjekësore, po të keni një të tillë. Askujt nuk do t'i refuzohet vaksina, ngaqë nuk është i siguruar. **Nuk do të keni nevojë të paraqitni kartë të Sigurimeve Shoqërore ose ID të lëshuar nga shteti, për të bërë vaksinën kundër COVID-19. Nuk do t'ju kërkohet asnjëherë numër karte krediti, për të organizuar një vizitë.**

### VENDET E VAKSINIMIT:

Vaksinat ofrohen në shumë sajte të ndryshme të hapura për publikun, si:



- **Një sajt vaksinimi masiv, i organizuar nga** Commonwealth-i i Massachusetts. Sajte të tilla janë, mes të tjerash, Gillette Stadium, Fenway Park, Eastfield Mall in Springfield dhe DoubleTree Hotel in Danvers. *Këto sajte aktualisht ofrojnë më shumë takime dhe publikojnë një numër të madh rezervimesh një herë në javë, çdo të enjte.*
- Disa **Borde lokale të shëndetit publik** që e ofrojnë vaksinën.
- Disa **farmaci lokale** që e ofrojnë vaksinën.
- Disa **ofrues të kujdesit parësor** do t'ua ofrojnë vaksinën pacientëve më pas, gjatë procesit të distribucionit të vaksinës. *Në qoftë se jeni të interesuar për ta marrë vaksinën COVID-19 nga ofruesi juaj i kujdesit parësor, nuk ka nevojë ta kontaktoni ofruesin tani për tani. Ofruesit e kujdesit parësor do t'ju kontaktojnë me më shumë informacion, ose për t'ju caktuar një takim, sapo të kenë vaksinë në dispozicion. Nuk ka listë-pritje për vaksinën ose ndonjë proces të ngjashëm regjistrimi me ofruesit e kujdesit parësor.*
- Në qoftë se jetoni në një [institucion strehimi publik ose privat të kualifikuar, për të moshuar me të ardhura të pakta, ky mund](#) të jetë duke planëzuar një klinikë vaksinimi brenda institucionit.

## SIGURIA E VAKSINËS:

Vaksinat kundër COVID-19 janë të sigurta. Vaksinat ekzistuese kundër COVID-19 janë miratuar dhe rekomanduar nga FDA-ja dhe Komiteti Këshillimor për Praktikën e Imunizimit i CDC-së, në bazë procesesh standard të testimit dhe të miratimit. Vaksinat u nënshtrohen testeve rigoroze dhe provave klinike masive, para se të miratohen për përdorim të gjerë. Vaksinimi është mbrojtja më e mirë për këta individë, për të ulur rrezikun e të sëmururit rëndë nga COVID-19. Për më shumë informacion rreth sigurisë së vaksinës kundër COVID-19, vizitoni [www.mass.gov/COVIDVaccineSafety](http://www.mass.gov/COVIDVaccineSafety).

## BURIME TË MËTEJSHME:

Informacioni për vaksinën kundër COVID-19 do të përditësohet rregullisht. Përdorni burimet e mëposhtme për më shumë informacion:

- [COVID-19 Vaccine Information in Massachusetts](#)
- [Latest COVID-19 Vaccine Updates in Massachusetts](#)
- [COVID-19 Vaccine Distribution Timeline and Eligibility](#)
- [Current COVID-19 Vaccine Locations](#)
- [Massachusetts COVID-19 Vaccination Program \(MCVP\)](#)
- [Information for staff and residents of long term care facilities, ALRs and Rest Homes](#)
- [Information for residents and staff of affordable senior housing](#)
- [Information for home-based health care workers](#)
- [COVID-19 Vaccine Frequently Asked Questions](#)
- [COVID-19 Vaccine Safety](#)
- [Sign-up for COVID-19 Alerts](#)